

SHTOJCE NR.02

E DOKUMENTAVE STANDARTE TE ANKANDIT

SHITJE SKRAP NË PRONËSI TË MPEJ

Mbështetur në nenin 27, të ligjit 9874, datë 14.02.2008 “Për Ankandin Publik” i ndryshuar dhe pikës 5.2, të VKM-së nr. 1719, datë 17.12.2008 “Për miratimin e rregullave të ankandit publik i ndryshuar

Autoriteti Kontraktor, pas paraqitjes së një ankimi nga një ofertues vendosi të marrë në konsideratë pjesërisht kërkimet e tij dhe vendosi të bëjë ndryshimet, si vijon:

Në kriterin e veçantë të kualifikimit, të vendosur në shtojcën 5 dhe në procesverbalin e hartimit të kriterëve të kualifikimit behën ndryshimet, si vijon:

Ishte:

10. OE ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë III.2.B në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme ose të ketë marrëveshje/kontrate bashkëpunimi me OE të cilët janë pajisur me licencën e mësipërme.

Licenca duhet të shoqërohet me aktin e miratimit ku të jone përcaktuar në bazë të VKM-së 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” mbetjet me kodet përkatëse, si vijon:

- 13 02 Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikante
- 13 02 06 * Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues
- 13 07 01 * Naftë dhe diezel
- 13 07 02 * Benzinë
- 16 01 Mjete jashtë përdorimit nga mënyrat e ndryshme të transportit (duke përfshirë mjete jorrugore) dhe mbetje nga çmontimi i mjeteve jashtë përdorimit dhe të mirëmbajtjes, (përveç 13, 14, 16 06 dhe 16 08)
- 16 01 03 Goma jashtë përdorimit
- 16 01 04 * Mjete jashtë përdorimit
- 16 01 07 * Filtra vaji, naftë
- 16 01 13 * Lëngje frenash
- 16 01 14 * Lëngje antingrirës që përmbajnë substanca të rrezikshme
- 16 01 15 Lëngje antigirirës, të tjera nga ato në 16 01 14
- 16 01 19 Plastika
- 16 01 20 Qelq

- 16 06 Bateri dhe akumulatorë
- 16 06 06 * Elektrolite të ndara të mbledhur nga bateri dhe akumulatorë të tjerë

Bëhet:

10. OE ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë III.2.B në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme ose te ketë marrëveshje/kontrate bashkëpunimi me OE te cilët janë pajisur me licencën e mësipërme.

Licenca duhet të shoqërohet me aktin e miratimit ku të jene përcaktuar në bazë të VKM-së 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve” mbetjet me kodet përkatëse, si vijon:

- 16 01 - mjete jashtë përdorimit nga mënyrat e ndryshme të transportit (duke përfshirë mjete jo rrugore) dhe mbetje nga çmontimi i mjeteve jashtë përdorimit dhe të mirëmbajtjes, (përveç 13,14,16 06 dhe 16 08).

Afati shtyhet me 5 (pesë) ditë.

Afati i fundit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje është: 17.07.2023, ora 12:00